



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

VENDIM

Nr 32 Datë 26.02.2026

PËR

MIRATIM SERVITUT KALIMI NË PRONË SHTET

Mbështetur në: *Ligji Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar neni 8 pika 2, neni 9 pika 11.2 dhe 54 si dhe në kërkesën e qytetarëve për të zhvilluar pronat e tyre duke hapur dritë në pronat shtet paraqesim këto kërkesa në Këshillin e Bashkisë për shqyrtim si më poshtë:*

Këshilli i Bashkisë, pasi u njoh me materialin, mbështetur në kompetencat që ka dhe pas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve,

VENDOSI :

I. Të miratojë servitut kalimi në pronë shtet si më poshtë:

Servitut kalimi sipas kërkesës së qytetarëve Olgers Azbi Shkëmbi, Erion Azbi Shkëmbi si pronarë të pasurive me nr. 499/10, vol. 12 fq. 54 dhe pasuria me nr. 499/12, vol. 12 faqe. 92 të ndodhura në zona kadastrale 1491, Njësia Administrative Qendër Bulgarec, fshati Dishnicë, për në pjesën perëndimore të dy pronave kufitare, në drejtim të pasurisë shtet me nr. 499/11, vol. 12 faqe. 55, të ndodhura në zona kadastrale 1491, Njësia Administrative Qendër Bulgarec, fshati Dishnicë. Për të bërë të mundur hyrje-daljen dhe shfrytëzimin normal të pronave, kërkohet krijimi i një kalimi (servitut) mbi pasurinë shtet, në përputhje me konfigurimin ekzistues të terrenit dhe kufijtë kadastralë, i cili synon:

- garantimin e aksesit funksional në pronë;
- mundësimin e ndërhyrjeve në objektin ekzistues të amortizuar;
- shmangien e izolimit faktik të pasurive përfituese.

II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimitt ë Kontratave të Infrastrukturës.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 25 vota

Vota Pro 25

Vota Kundër 1


Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 26-02-2026

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI





Pasuri Shtet me nr. 499/11, vol. 12
faqe. 55 e ndodhura në zona kadastrale
1491, Njësia Administrative Qendër
Bulgarec, fshati Dishnicë.



Pasuritë nr. 499/10, vol. 12 fq. 54 dhe
pasuria me nr. 499/12, vol. 12 faqe. 92
të ndodhura në zona kadastrale 1491,
Njësia Administrative Qendër
Bulgarec, fshati Dishnicë.



Hartoi: Arjola Çela